

Eksperiencia e Velipojës për zhvillimin e turizmit lokal

Ismail BEKA, GTZ

Konferenca Pan-Himariote është një ngjarje e rëndësishme për krahinën në fjalë, pasi këtu po rrihen dhe do të vazhdojnë të rrihen mendime për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të zonës, ku turizmi padyshim është me rëndësi të veçantë. Në referimtim do të mundohem të sjell diçka nga përvoja e zhvillimit të këtij sektori nga puna e bërë nga GTZ në një zonë të ngjajshme- atë të Velipojës. Unë shpresoj së disa nga këto “mësime” të nxjerrë nga puna jonë në veri të Shqipërisë, të jenë të vlefshme edhe edhe për zonën e Himarës.

Të dhëna të përgjithshme mbi Velipojen

Komuna Velipoje shtrihet ne Veri te Shqiperise dhe ne jug te Shkodres. Ajo ka nje siperfaqe prej 72,40 km². Ne veri ajo kufizohet me komunen Dajç, ne jug me detin Adriatik, ne lindje me prefekturen e Lezhes dhe ne perendim me lumin Buna. Komuna Velipoje perbehet nga 10 fshatra dhe ka nje popullsi prej 8146 banore. Pozita e favorshme gjeografike ku nderthuren deti dhe lumi, laguna dhe rezervati natyror, fushat pjellore dhe pyjet, kodrat dhe malet i japin kesaj komune nje mundesi te madhe per zhvillimin e turizmit detar (ka 14 km plash te nje cilesie te larte), lumor dhe malor, gjuetise dhe peshkimit, e kulturave te ndryshme bujqesore dhe blegtorise.

Megjithë mundësitë për zhvillim, Velipoja perballet me nje situate te veshtire ekonomike. Infrastruktura rrugore (rruget e brendshme dhe ato rurale) eshte pothuajse krejtesisht e amortizuar. Sistemi i kanalizimeve te ujrave te zeza mungon krejtesisht (ekzistojen vetemgropa septike). Sistemi i kanalizimeve te ujrave te bardha pothuajse nuk funksionon fare. Kanalet kulluese ne funksion jane ato paresore dhe dytesore, ndersa kanalet kulluese te treta jane jashte funksionimit. Kanalet ujtese jane krejtesisht jashte funksionimit. Sistemi i ujesjellesit eshte i amortizuar dhe nuk mbulon nevojat e banoreve me uje te pijshem. Ndricimi rrugor mungon krejtesisht. Sherbimi telefonik publik mungon ne te gjitha fshatrat e komunes me perjashtim te fshatit Gomsiqe e Re (nje numer telefoni).

Sherbimi social dhe shendetesor jane nivel shume te ulet. Qendra shendetesore ne qender te komunes nuk mbulon nevojat e banoreve te Velipojes. Mungojne krejtesisht çerdhet dhe kopshtet publike per femijet, shkollat jane te pamjaftueshme per te mbajtur kapacitetin ne rritje te numrit te femijeve. Numri i pensionistevë eshte 813 dhe i familjeve qe trajtohen me ndihme ekonomike eshte 80. Pjesa me e madhe e banoreve punojne ne bujqesi dhe blegtori, me pak ne sektorin e ndertimit. Megjithë mundësitë e medha për punë, papunesia është e lartë.

Pavaresisht tokave pjellore, ne pjesen me te madhe ato jane te papunuara. Kjo per faktin e problemeve te ligjit mbi token, ngastrave te vogla, çmimit te larte te punimit, rendimentit te ulet te prodhimit dhe te mosshitjeve te produkteve.

Turizmi

Po te udhetosh ne jugperendim te qytetit te Shkodres, rreth 30 km, do te mberrish ne plazhin e Velipojes. Ky bregdet eshte nje perle e natyres shqiptare ku gershetohen harmonishem deti, lumi, plazhi, pylli, laguna e mali. Gjatesia e plazhit eshte 14 km dhe gjeresia rreth 300 m. Velipoja eshte plazhi me i ri i vendit me nje moshe jo me shume se 300-vjeçare. Deri ne vitet '80 turizmi ka qene shume i kufizuar per shkak te afersise me zonat kufitare. Madje per te kaluar ne rrugen per ne Velipoje duhej qe te pajiseshe me nje leje te veçante kalimi nga organet e rendit.

Rera eshte e pashfrytezuara dhe uji eshte kristal i paster. Ne afersi ndodhet edhe rezervati i gjuetise. Plazhi ka vlera te medha kurative dhe kushtet klimatike jane shume te favorshme per plazh gjate tre muajve te veres. Por fundjava eshte koha kur shume shkodrane dhe vizitore nga vende te ndryshme gjejne prehje ne kete vend. Aty ka mundesi te ndryshme argetimi. Jo vetem plazhi dhe bukuria natyrore te zhytin drejt ketij vendi, por dhe pjesa me zbavitese, qe ka te beje me pasionin e njerezve te veçante per te peshkuar dhe per te gjuajtur lepuj. Ne keto vitet e fundit Velipoja eshte mbushur me hotele dhe shtepi luksoze per pushuesit.

Planifikimi urban dhe hapsinor

Situata urbanistike ne plazhin e Velipojes ka arritur ne piken kritike dhe situata eshte akoma e pazgjidhur ne kendveshtrimin nese plazhi i Velipojes mund te jete nje plazh turistik cilesor ne te ardhmen, apo do te sherbeje per kategorine e ulet (pa shume pretendime) te vizitoreve. Plazhi i Velipojes para viteve 90 ka pasur disa kabina dhe 3-4 hotele. Ne fillimin e viteve 90 rreth plazhit ka pasur ndertime me konstruksione te lehta, kryesisht per qellime tregtare. Duke perjashtuar disa raste ne fshatin Pulaj, nuk ka pasur kthime prone per ish-pronaret ne territorin rreth plazhit. Ne vitin 1995 eshte miratuar zyrtarisht nje masterplan i hartuar nga studio italiane duke e parashikuar plazhin e Velipojes nje plazh te turizmit cilesor, me hapësira per fshatra turistike dhe me nje arkitekture ne perputhje me ambientin. Por administrata shteterore nuk parashikoi se si do te realizohej ky plan. Pas vitit 1997 filluan ndertimet ne territorin e plazhit, ndertime qe nuk kane pasur lejen perkatese. Ne pergjithesi

ndertuesit kane lidhur marreveshje me ish-pronare ose pretendues per pronare (por qe, me perjashtim te tokave bujqesore te kthyer me Ligjin nr. 7501, nuk kane dokumentacion pronesie te viteve te fundit). Intensiteti i ndertimeve eshte shtuar ne vitet e fundit, me parashikimin se ndertimet do legalizohen.

Tashme kemi rreth 500 ndertime kryesisht te perqendruara ne zonen e plazhit, por dhe pergjate rruges se lagunes se Vilunit. Ne shumicen e parcelave ndertimet jane te vendosura ne menyre kaotike, me akses problematik, me cilesi te te gjitha llojeve dhe me aspak atraktivitet arkitektonik e peisazhi. Ne plazh, ndonese ka drita dhe furnizim te pjesshem me uje, nuk ka infrastrukture qendrore per te perballuar kerkesen aktuale te plazhit dhe nuk ka kanalizime per ujrat e zeza. Po keshtu menaxhimi i mbeturinave eshte problematik dhe pervec zones se plazhit ku komuna po mbeshtetet nga GTZ, organizimi i ketij sherbimi perreth zones se ndertimeve akoma nuk eshte i organizuar.

Aktualisht, gjate 2-3 viteve te fundit nga Instituti i Studimeve Urbanistike, eshte pergatitur nje plan tjetër urbanistik, i cili eshte munduar te marre ne konsiderate situaten aktuale te ndertimeve.

Ky plan ka mjaft probleme. Ne radhe te pare nuk eshte i organizuar ne koordinata dhe mbivendosja me hartat tregon mosperputhje. Thelbi i planit eshte ndarja e territorit ne parcela dhe organizimi i rjetit te rrugeve ne forme kuadrati. Parcelat jane te organizura ne zona me densitet te ulet, te larte, hoteliere, tregtare, etj. Nje model tipik edhe per masterplanet e hartuara ne zonen e Golemit, eshte zoterimi i zonave me densitet te larte qe nuk eshte aspak i qendrueshem dhe terheqes per turizmin. Ky plan nuk ka marre ne konsidrate studime paraprake per ambientin, infrastrukturen dhe nuk detajon procedimin ne hapa te metejshme. Ne zonen me ndertime te perqendruara ekzistuese ai nuk hyn brenda parcelave per te zgjidhur kaosin e krijuar. Pervec kesaj rruget e parashikuara mund te kishin evituar prishje te panevojshme ndertimesh.

Situata ne Velipoje eshte emergjente vecanerisht ne zonen ku kane filluar ndertimet (drejt Vilunit), zone kjo qe mund te ishte e pershtatshme per nje turizem cilesor. Ndaj dhe ngrirja e ndertimeve ne situaten aktuale, studimi me i kujdesshem i zones pak te prekur dhe zgjidhja me e shpejte e zones me ndertime te shumta per t'i hapur rruge legalizimit dhe per bere te mundur nderhyrjen me infrastrukture, duhet te jene hapa mjaft te shpejte. Tashme pervec atyre qe kane perfituar nga shitja e tokes, askush nuk eshte i qarte se cfare do te behet ne Velipoje.

Analiza SWOT dhe Analiza e aktoreve

Pjesemarresve ne workshop iu kerkua qe te jepnin mendimin e tyre rreth pikave te forta, pikave te dobta, mundesive dhe kercenimeve me te cilat perballej Komuna Velipoje. Te gjitha idete e shprehura u vendosen ne tabele dhe me pas u grupuan ne baze te afersise.

Analiza SWOT (pikat e forta, pikat e dobta, mundesite, kercenimet)

Pikat e forta: pozita gjeografike (afersia me Shkodren, largesi e shkurter nga rruga nacionale, afersia me Malin e Zi); burimet e shumellojshme natyrore (biodiversitet, deti, lumi Bune, mali, pyjet); kushte te favorshme klimaterike; larmi te resurseve turistike; toke pjellore; produkte tradicionale; burimet njerezore dhe force aktive per pune; migrim i paket; vije bregdetare e pandotur me rere shume te mire; bregdet i pashfrytezuar

Pikat e dobta: infrastrukture e pazhvilluar (rruge te prishura, mungesa e ujit te pijshem, mungesa e energjise elektrike, mungese e kanalizimeve per ujrat e zeza; mungese e nje strategjie zhvillimi; ndertimet e paligjshme; shoqeri civile e dobet; mungese e sherbimeve sociale; pasivitet i organeve te qeverisjes qendrore; aktivitet i paket bujqesor; mungese koordinimi ndermjet institucioneve dhe ndermjet institucioneve e organizatave; kapacitet i ulet per menaxhimin e territorit dhe te sherbimeve (mungese e burimeve financiare, mungese ne burimet njerezore, mungese e autoritetit te pushtetit vendor, pamundesi per te ofuar sherbimin e pastrimit; mungese e perfshirjes se publikut ne vendimarrje; kulture e paket sherbimi ne fushen e hotelerise.

Mundesite: zhvillimi i turizmit; aftesi per rritjen e kapaciteteve akomoduese; agroturizmi; zone atraktive per projekte zhvillimi; mbeshtetje me e madhe nga qeveria qendrore; zhvillimi i sporteve te ujit dhe gjuetise; rritja e pranise dhe e mbeshtetjes teknike e financiare te donatoreve; rritja e prodhimit bujqesor e blegtoral; bujqesia industriale dhe bimet medicinale; vullnet per ndryshim

Kercenimet: mungesa e studimit urbanistik; zhvillimi i paplanifikuar; vizioni i paqarte per zhvillimin e turizmit; veshtiresia e zbatimit te kuadrit ligjor per ndarjen e tokes; pronesia e diskutueshme mbi ndertimet; korrupsioni ne Zyren e Rregjistrimit te Pasurive dhe ne zyren e urbanistikes; deshtimi i projekteve zhvillimore; ndotja e mjedisit (nga ujrat e zeza, nga mbetjet urbane dhe nga mbetjet e ngurta; konkurrence e vendeve fqinje; rregjimi uJOR (Buna, deti, ujrat e nendheshem); indiferenca e autoriteteve shteterore per te ndryshuar gjendjen;

semundjet virusale (me ane te shpendeve migrues ; vonesa ne marrjen e masave per permiresimin e situates.

Zhvillimi ekonomik lokal ne Velipoje – pervoje dy vjecare e ne projekt pilot per zhvillimin e turizmit, bujqesie, tregut dhe mjedisit.

Krijimi i modeleve te zhvillimit ekonomik - pilote

I gjithë veriut ndodhet ne harten e varferise. Objektivi i vitit te pare te kooperimit eshte, te bashkepunojme me nje komune qe eshte e gatshme te punoje per tu larguar nga kjo harte dhe per te zevendesuar me harten e zhvillimit. E tille u zgjodh Komuna e Velipojes. Ne fillim te vitit 2004 kishte 90 familje qe perfitonin ndihme ekonomike te papunesise, ose mungeses se resurseve ekonomike per te jetuar.

Velipoja ishte nje nga zonat me te frekuentuara turistike ne sezonet verore 2004-2005. Numri i pushuesve nga Shkodra, veriu i Shqiperise, Kosova dhe vende te tjera, ne gjithë periudhen korrik-gusht ishte mbi kapacitetin normal te Velipojes. Hotelet e saj dhe te gjithë ambientet e tjera akomoduese kane patur shfrytezimin e tyre me te mire ne vite. Ne fundet e javes numri i pushuesve arrinte ne 60-70 mije persona, nderkohe qe ne ditet e zakonshme deri ne 30 mije persona.

Sezonet turistike 2004 dhe 2005 per Velipojen krijuan rrugen e bashkepunimit midis Komunes Velipoje, Sektorit privat te turizmit, fermereve dhe me mbeshtetjen e Qarkut Shkoder, Ministrise se Punes, Ministrise se Turizmit dhe Ministrise se Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit si dhe GTZ-se.

GTZ-ja ka bashkepunuar per te realizuar tre projekte ne Velipoje. Kooperimi jone nuk eshte bazuar ne financime te medha te aktiviteve dhe projekteve ne Velipoje. Ne se do te benim fjale per shifra ne EURO, ato jane ndoshta me te vogla ne krahasim me cdo projekt te tjetër qe ka vepruar deri tani ne Velipoje. Na eshte dashur ta fillojme bashkepunimin ne muajin mars 2004. Ne takimin e pare krahas me komunen ftuam biznesin privat te hotelerive restoranteve si dhe me sektorin privat bujqesor.

Diskutimi i pare ishte jo per te parashtuar nje projekt, por per te diskutuar per problemet qe ka Velipoja. Edhe pse nje rajon me pasuri unike persa i perket resurseve turistike e bujqesore, gjendja e pergjithshme ekonomike e Komunes ben pjese tek komunat e varfera. (rreth 90 familje te perfshire ne skemen e ndihmes ekonomike), mungesa e fondeve financiare per Komunen, jo vetem per promovimin e turizmit, por as per te organizuar

pastrimin e plazhit. Mungesa e bashkepunimit dhe besimit reciprok midis Komunes dhe sektorit privat. Mungese motivacioni e fermereve per te prodhuar dhe shume siperfaqe toke e papunuar prej vitesh.

Natyrisht shume me te medha ishin problemet e infrastruktures, energjise elektrike, instalimit te ujit te pijshem dhe kanalizimeve. Biznesi i turizmit me nje sezon shume te shkurter dhe jashte kesaj kohe veshtire te takoje njerez per te biseduar me to per problemet dhe rruget e zgjidhjes.

Baze e bashkepunimit qe ne fillim u ndertua ne mirebesimin reciprok midis aktoreve dhe ne ndarjen e roleve dhe pergjegjesive.

A. Promovimi i broshures “informacionit per turizmin ne Velipoje”

Projekti me i thjeshte ishte informacioni per hotelet ne Velipoje. Dy studente te deges se Turizmit ne Fakultetin Ekonomik ne Shkoder, u angazhuan per grumbullimin e informacionit te gjithe kaapcitateve akomoduese dhe mbi kete baze u botua broshura turistike qe ishte shume e domosdoshme per te bere te njohur Velipojen turistike.

Nje arritje e vecante ne Velipoje ishte edhe mirekuptimi i sektorit privat te turizmit per te krijuar shoqaten e hotelerive, e cila tashme eshte e organizuar dhe nje bord me pese vete, te kryesuar nga zoti Gjergj Kroni, eshte nje institucion i rendesishem ne realizimin e projekteve.

B. Projekti per pastrimin e zones se plazhit ne Velipoje-

Projekti me i veshtire ne konceptim dhe realizim eshte ai i pastrimit te plazhit. Ne kete projekt te gjithe aktoret ne Velipoje ishin skeptik dhe nuk shpresonin se ka nje zgjidhje. E para veshtiresi: fondet (Komuna kishte vetem 1 milion leke ne buxhetin e saj), e dyta mungesa e mjeteve te transportit komunal (asnje mjet te tille), koshave te plehrave dhe vendeve te grumbullimit dhe se treti mungesa e kultures qytetare per nje ambjent te paster, cka eshte e dukshme ne te gjithe teritorin e vendit. Nje Joint-Ventur i premtuar nga nje shoqate italiano-shqiptare nuk kishte dhene efekte e dhe ne vitet e kaluara.

Nisur nga fakti qe ne Komunen e Velipojes ka shume familje qe jetojne me ndihme ekonomike, mjaft prej te cilave realisht kane nevojte per tu mbeshtetur, se bashku me Komunen i propozuam Ministrise se Punes dhe Ceshtjeve Sociale dhe Ministrise se Pushtetit

Vendor dhe Decentralizimit perfshirjen ne projekt pilot per nxitjen e punesimit nga skema e ndihmes ekonomike ne pune komunale per 35 veta.

Ne i pershendesim te dy Ministrite per pranimin e ketij propozimi dhe berjen te mundur qe brenda nje kohe fare te shkurter, Zyra rajonale e asistences sociale ne Shkoder se bashku me Komunen arriten te zgjedhin punetoret dhe te fillojne nga puna qysh nga java e pare e qershorit. Ministria e Rrregullimit te Territorit dhe Turizmit kontriboje me kamjuncine per transportin e mbetjeve, GTZ-ja me finacimin e nje drejtuesi te ketij projekti dhe Komuna me bazen materiale te punes. Mbeshtetes u bene edhe kompani private, qe kontribuan me materile per pergatitjen e mjaft kazaneve te plehrave, qe tashme jane shperndare ne pjesen qendrore te plazhit.

Natyrisht qe nuk eshte arritur te zgjidhet pastrimi i zones se plazhit ne Velipoje. Ne nje dite normale ne palzhin e Velipojes mund te dalloni qe gjithkund ka plehra te mbetur nga vitet e kaluar e te reja qe hidhen aktualisht e nuk pastrohen, por nje gje e shte e sigurte, ketu ka nje dallim shume te madh me situaten qe ka qene para fillimit te punes deri ne ditet e para te qershorit.

Media do te kishte nje rol shume te madh ne ndergjegjesimin e qytatareve, ndoshta krahas me pasqyrimin e realitetit ashtu edhe me evidentimin e veprimeve te ndyshme te qytetareve ne ambientet publike te plazhit.

C. Projekti i tregut bujqesor, qe perfaqeson nje treg te thjeshte per te shitur fermeret prodhimet e tyre te fresketa.

Projekti i trete ka te beje me zhvillimin e fermave bujqesore dhe lidhja me tregun e turizmit. Ndertimi i nje tregu shitje per fermeret e orientuar per treg, u konsiderua si forma me e mire per promovimin e prodhimeve lokale dhe mbeshtetjen e fermereve. Ne ket menyre u konceptua ngritja e nje tregu per rreth 30 fermere qe shesin cdo dite ne treg. Nje kompani lokale ne Velipoje mori persiper dhe ka realizuar me cilesi te gjitha paisjet e tregut dhe me siguri, me kete treg dhe vecanerisht bashkepunimin e Komunes me pronare privat te vendit ku eshte ndertuar tregu dhe me mbeshtetjen e GTZ-se perben nje projekt pilot model edhe per zona te tjera te vendit.

PR shume e rendesishme / Informacion

Velipoja dhe Vlora ishin gjate veres se viteve 2004-2005, dy tregjet me te frekuentuara (ne krahasim me kapacitetet e tyre) te turizmit ne Shqiperi. Ministri i Turizmit me shume se

nje here ka permendur ne komunikimin zyrtar me Median per suksesin e tregut te turizmit ne Velipoje.

Ndër përpjekjet e rëndësishme mund të përmëndim“

- logo turistike e Velipojes dhe udhëtimi turistik ne Velipoje – piktura te studenteve te liceut artistik. <http://groups.msn.com/busulla>
- Produkt nje harte Udhëtimi turistik ne Velipoje.
- Film per Delten e Bunes, ne festivalin nderkombetar Nitra, Sllovakia, Oktober 2004, Fuat Memeli (GTZ).
- Delta News, July 2004 (GTZ)
- Projekt per biodiversitetin ne Velipoje _ (Euronatur deutschland)
- Foto galery per Velipojen dhe rajonin nga Horst Wagner, www.eup-images.com .

Une i permenda ne menyre analitike keto tre projekte, te cilat jane shume te lidhura me njera tjetren dhe perbejne nje kontribut sado te vogel per zhvillimin ekonomik ne Velipoje.

Natyrisht ne flasim per rezultate te arritura, qe jane simbolike dhe i perkasin akoma nje niveli te ulet te zhvillimit te turizmit ne Velipoje, krahasuar me resurset e shkelqyera qe ka kjo zone.

Propozimi i projekti PPP me Komunen Velipoje dhe biznesin privat per mjedisin (pastrimin e mbeturinave, ujrat e zeza dhe banjot publike).

Riciklimi i mbeturinave

Jane evidentuar tre kompani shqiptare, te cilat jane te gatshme te marrin nga Velipoja materialin e grumbulluar, te seleksionuar dhe te presuar te mbetjeve, te letres dhe plastikes, nderkohe qe nuk perben me problem ambalazhet e aluminit dhe mineraleve te tjera pasi ato grumbullohen ne baza komerciale. Kontaktet e para me drejtuesit e ketyre kompanive krijojne nje situatë optimiste ne se GTZ-ja do te mbeshtese nje projekt te tille pilot edhe nje zone sic eshte Velipoja prej 110 km nga Tirana.

Bashkepunimi do te filloje me hotelet, restorantet dhe njesite tregtare dhe investuesit qe krijojne mbeturina. Me to do te punohet per te arritur ne ndarjen e ketyre mbetjeve. Kjo do ta lehtesonte shume punen e projektit (mbi 50% e mbetjeve vjen nga keto lokale).

Ne te gjithë teritorin e plazhit do te ndertohej sistemi i ndarjes te ambllazheve, do te importohet nje prese per paketimin volumor te materialeve plastike ne nje ambjen te pershtatshem prane vendit te hedhjes se mbeturimave.

Programi i GTZ-se do te mbeshtesi hartimin e nje plani biznesi per nje projekt te tille pilot dhe mundesine e realizimit si projekt-PPP, me pjesmarrjen e Komunes se Velipojes, Sherbimit Social (puneshim te personave qe marrin asistencë sociale-ndihme ekonomike te papunesise), Kompanive private, Shoqates se Hotelerive ne Velipoje, GTZ-se dhe aktoreve te tjere ne rajon qe do te perkrahin dhe mbeshtesin nje projekt te tille. Projekti mendohet te filloje nga zbatimi qysh ne fillim te vitit 2005 dhe ti paraprije sezonit turistik ne Velipoje.

Rasti studimor i Komunes se Velipojes

GTZ po zbaton nje projekt per zhvillimin rajonal dhe perkrahjen e puneshimit ne zonat e pazhvilluara te Shqiperise Veriore. Ne kete kuader InWEnt dhe GTZ po drejtojne kete workshop per perpunimin e nje Koncepti per Zhvillimin Rajonal.

Pjesemarrshimit ne workshop ishin perfaqesues te komuniteteve nga Kukesi, Shkodra dhe Velipoja, pronare hotelesh, akademike dhe studente. Qellimi i workshopit ishte sensibilizimi i stakeholdersave per problemet dhe nevojat e partnereve te tyre. Workshopi u organizua ne tri fusha kryesore pune. Se pari, pjesemarrshimit u informuan rreth Politikave te BE-se mbi Zhvillimin Rajonal dhe ofroi elemente te analizes SWOT per Veriun e Shqiperise. Gjithashtu pjesemarrshimit moren nje informacion te pergjithshem mbi Komunen e Velipojes dhe mundesite e saj persa i perket turizmit. Nje prezantim tjetër u mor me aktivitetin e GTZ per te perkrahur dhe mbeshtetur prodhimin bujqesor dhe marketingun ne Velipoje. Perfaqesuesit u informuan rreth rezultateve te pyetesorit mbi Turizmin ne Velipoje dhe me pas u njohen me problemet lidhur me masterplanin urbanistik te Velipojes. Thomas Wehinger prezantoi para pjesemarrshimit ceshtjen “pse kemi nevojë per zhvillimin rajonal” dhe u realizua analiza SWOT per Velipojen.

Ne pjesen e dyte te workshopit pjesemarrshimit bene nje analize SWOT per Velipojen. U grumbulluan fjalet kryesore te problemeve, vizioneve dhe ideve per Velipojen. Gjithashtu, nga ana e pjesemarrshimit u identifikuan edhe stakeholdersat.

Ne ditën e dyte te workshopit, qe u mbajt ne Velipoje, pjesemarrshimit te ndare ne gjashte grupe pune, intervistuan disa nga stakeholdersat e permendur me perpara. Intervistat u realizuan me zyrtare te Komunes se Velipojes, sipermarrshimit, pronare hotelesh, nxenes te

shkolles se mesme, banore te fshatit dhe me fermere. Informacioni i mbledhur u grupua ne tabela. Pastaj secili grup prezantoi rezultatet e veta para pjesemarresve te tjere.

Nepermjet kesaj metode pune, problemet, vizionet dhe idete e anetareve te komunitetit ne Velipoje u bene te dukshme dhe u reflektuan nga pjesemarresit, se bashku me informacionin e pergjithshem mbi komunen dhe zhvillimin e ekonomise rajonale.

Rasti studimor i Velipojes sherbeu si eksperience praktike per pjesemarresit, si dhe rriti shkallen e ndergjegjesimit te pjesetareve te komunitetit dhe stakeholdersave te Velipojes qe u bene pjese e ketij rasti studimor.

Analiza e Problemit dhe vizioni i zhvillimit

Gjate diskutimit qe u zhvillua ndermjet pjesemarresve, u be e mundur identifikimi i shpejte i aktoreve ne Komunen Velipoje. U diskutua parimisht mbi ndikimin e tyre ne situata te ndryshme zhvillimore, por nuk u be nje renditje sipas peshes qe mund te zinte secili. Te gjithë grupet e aktoreve u intervistuan dhe rezultatet e intervistave jepen me poshte:

A. Biznesmenet e zones:

Mungesa e energjise elektrike; sistemi rrugor i brendshem; kanalizimet e ujrave te zeza; papunesia; pronesia e tokes; mungesa e Masterplanit; ndertimet pa leje (asnjeri nuk nderton sipas rregullave); mungese interesimi nga shteti (i eshte dhene prioritet Jugut); veshtiresi per marrje kredie (interesa te larta); mungese kompetencash nga ana e Komunes; qender e madhe turistike; rritja e investimeve publike dhe private; zgjerimi i zones turistike (Plazhi – Maja e Zeze - Shengjini); ndertimi aksit Shengjin – Velipoje – Ulqin; rritja dhe zhvillimi i agrobiznesit; kthimi i Velipojes ne Bashki; Zgjerim i infrastruktures sociale (shkolla, qendra shendetesore, qendra argetimi, etj.); rritja dhe zgjerimi i investimeve; pjesemarrje ne vendimarrje;

B. Përfaqesues te Komunes:

Perfaqesuesit e komunes e shohin Komunen e Velipojes te zhvilluar ne drejtim te turizmit, por duke pasur si mbeshtetje edhe bujqesine dhe blegtorine. hartimi i Masterplanit te plote; dhenia e statusit “Bashki turistike”; perkushtim; bashkepunim; koordinim; pjesemarrje ne investime, duke perdorur te ardhurat lokale; permiresimi i infrastruktures; perfundimi i ujesjellesit ne zonen e plazhit; permiresimi i furnizimit me energji elektrike; menaxhimi i ujrave te zeza; menaxhimi i mbeturinave; perkrahje e paket nga qeveria qendrore; decentralizimi, sidomos ne lidhje me te ardhurat e pakta nga granti i pakushtezuar; per plazhin

konsiderohet shume e rendesishme zgjidhja e problemeve te meposhtme: pronesia mbi token (kryesisht ne zonen e plazhit); hartimi i planit urbanistik ; legalizimi i ndertimeve pa leje

C. Te rinj te shkolles se mesme:

Rruget e pashtruara; mungesa e energjise elektrike; papastertia; mungesa e jetes kulturore, artistike dhe sportive; me infrastrukture me te mire ; me e paster; me me shume investime nga shtete te tjera; te rregullohen e mirembahen rruget; te mbahen paster ambjentet publike dhe fshatrat; te kete qetesi (rend publik); te rriten kapacitetet intelektuale te te rinjve; te kete me shume aktivitete kulturore, artistike dhe sportive; te ulen taksat

Pas diskutimit te orientuar sipas pikave te pyetesorit, me nxenesit e shkolles se mesme u zhvillua edhe nje bisede e lire rreth gjerave qe ata deshironin me shume. Ja shume prej pergjigjeve te tyre: fushe futbollit, fushe volejbollit, park lojrash, salle kompjuterash (internet), kinema, peme per hije, stola ne qender, palester, autobus per transportin e nxenesve qe vijne nga larg, biblioteke ne shkolle dhe librari publike, uniforma shkolle, uniforma e mjete sportive, mjete mesimore (laboratore), rruge te asfaltuara, pune, drita, shkolla te rregullta, shtepi te rregullta, kopshte femijesh, teleferik Maja e Zeze – Rrjoll, piste avionesh; te ndihmojme per zbatimin e ligjeve; te bashkepunojme per zhvillimin; te bashkepunojme per rritjen intelektuale; bashkepunim i komunitetit me drejtuesit per ta permiresuar Velipojen; te ndihmojme ne permiresimin e jetes kulturore, artistike e sportive;

D. Banore te zones:

Infrastruktura (drita, uje, rruge); permiresimi i kanaleve kulluese dhe ujites; mungesa e tregut; mentaliteti (fanatizmi); renia e nivelit te mesimdhenies; konfliktet e pronesise; ndihme e paket nga qeveria dhe komuna; mungesa e sherbimeve sociale (qendra per grate, qendra shendetesore, kopshte); cfare te prodhohet te shitet; drita e uje pa nderprerje; rruge; kopshte; sherbim shendetesor 24-orësh; toka te punuara; vend me qytetar (me shume punesim ne aktivitetet jo-bujqesore, hapja e qendrave kulturore, etj.); nderhyrja e shtetit (per sigurimin e tregut, subvencione, ndihme per grupet e fermereve, permiresim te infrastruktures); zhvillimi i turizmit; arsimim profesional; shfrytezim i plazhit si burim fitimi; shlyerja e rregullt e detyrimeve ndaj shtetit; edukimi sa me i mire i femijeve; krijimi i grupeve te ndryshme shoqerore (forcim i shoqerise civile); rritja e cilesise se prodhimeve; perkushtim per zhvillimin e Velipojes

E. Përfaqesuesit e Shoqates së Hoteliereve:

Hartimi i masterplanit dhe zgjidhja e problemit te pronesisë; studimi i plan-vendosjes (hartim i nje rregulloreje per ndertim); permiresim i infrastruktures (kanalizimet e ujrave te zeza, uji i pijshem, energjia elektrike, mosorganizim i qendres se plazhit); mungesa e kurseve te trajnimit profesional; mungesa e zyres se informacionit turistik; pastrimi i plazhit dhe gjelberimi; pasiguria per investime; pamundesi rreditimi; me shume turistë; nje zone formale persa i takon zhvillimit; zona me e mire turistike ne rajon; zone turistike me rritje te prodhimeve bujqesore; vendosja e dores se shtetit; te veprohet menjehere, sepse cdo minute qe kalon eshte vone; bashkepunim me njeri-tjetrin per gjetjen e zgjidhjes urbanistike; investime; pagimi i taksave; investime ne zonen perreth

F. Përfaqësuesit e grupit të fermerëve:

Infrastruktura e pazhvilluar (rrugët, sistemimet fushore, energjia elektrike); marketingu (cmimet e ulta, konkurrenca e pandershme nga jashte); mbeshtetje nga shteti (subvencione, kredi te buta dhe afatgjata); problemet e pazgjidhura te pronesisë; infrastrukture e rregulluar (rruge, sisteme hidrike, energji elektrike); masterplan funksional; zone turistike cilesore; zgjidhje e problemit te legalizimeve; fuqizim i Komunes, decentralizim real i pushtetit vendor; zhvillimi i industrise agroperpunuese; zhvillimi i panaireve; ide, projekte, aktivitete; sigurimi i kredive; investime sipas studimeve afatgjata ; kualifikime dhe trajnime; mbeshtetje nga shteti dhe OJQ; niveli ne rritje i shkollimit te komunitetit; pjesemarrja aktive ne forume dhe veprimtari te perbashketa; prodhime ne sasi, kohe dhe cilesi; organizimi ne shoqata; rritja e nivelit te sherbimit; bashkepunim me organet qeverisese te pushtetit vendor dhe me OJQ.

Përveç gjashtë grupeve te mesiperme, ne patem mundesine te kishim edhe mendimin e disa peshkatareve dhe pylltareve. Ne menyre te permblodhur ato kishin keto problematika: pakesimi i siperfaqeve te gjelberta, moszbatimi i ligjit, kushtet jo te mira te punes, mungesa investimeve, mungesa e nje plani lokal zhvillimi.

Persa i perket vizionit, mund te themi se ata shihnin nje forcim te ligjit, shpalljen kategori te rendesishme te mbrojtura, shfrytezimin e zonave per ekoturizem, kthimin ne zona me rendesi didaktike, shkencore, biologjike. Zhvillimin e metejshe me konceptonin ne shtim te siperfaqeve te gjelberta, mbrojtje te burimeve natyrore, permiresim dhe stabilizim te çeshtjeve te pronesisë.

Përmbledhje

Autori sjell në vëmendje të auditorit eksperiencën e punës së GTZ me rajonin e Velipojës, duke analizuar në mënyrë të veçantë zhvillimin e turizmit në këtë zonë, si shëmbull i vlefshëm përgjithësues edhe për zona e tjera turistike. Analiza SWOT (pikat e forta, pikat e dobta, mundesite, kercenimet) e bërë me përfaqësues të gjithë grupeve të interesit nxorri në dukje se ç'mendojnë ato për gjëndjen si dhe mënyrat për zgjidhjen e tyre. Mbi bazë të tyre GTZ ka ndërmarrë edhe inisiativa që synojnë përmirësimin pjesor të këtyre mangësive sikunder ishin Promovimi i broshures “informacionit për turizmin në Velipoje”, Projekti për pastrimin e zones së plazhit në Velipoje, Projekti i tregut bujqësor, që përfaqëson një treg të thjeshtë për të shitur fermerët prodhimet e tyre të freskëta, fushata PR (Public relations) si shumë e rëndësishme për dhenje informacioni si dhe propozimi i projekti PPP me Komunen Velipoje dhe biznesin privat për mjedisin (pastrimin e mbeturinave, ujrat e zeza dhe banjot publike).

Summary

The author brings into the attention of the audience the experience of the work done by GTZ in the communa of Velipja, analyzing in particular the development of tourism in the area as an important generalizing example to be pursued in other turistic areas. The implementation of the SWOT analysis (Strong points, Weak Points, Opportunities, Threats) done with all the stakeholders, brought in evidence what they think of and options of things to be done. Based on this GTZ has undertaken initiatives, supported by the local community, that aim in partial improvement of these deficiencies such promotion of the booklet “Tourism information for Velipoja”; the project for cleaning the beach area; the agricultural market project, that represent an important market for the farmers to sell their own products, public relations project as very important campaign for giving information to the public as well as the project with the local government and the private business for the environment (cleaning of the garbage, waste waters and public toilets).